

V E N D I M
Nr.437, datë 10.6.1996

**PËR DERDHJEN NË BUXHETIN E SHTETIT TË FONDIT KUNDËRPARTI TË
NDIHMAVE SHTETËRORE QË TRAJTON E SHET REZERVA E SHTETIT**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat nga shitja e ndihmave shtetërore që do t'i jepen Shqipërisë do të trajtohen me marrëveshje të veçantë ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe donatorëve, ku do të përcaktohen qëllimi i përdorimit dhe afatet e derdhjes së tyre në buxhetin e shtetit.

2. Shitja e këtyre mallrave ndihmë shtetërore do të bëhet vetëm me formën e ankandëve të hapura publike.

3. Shpenzimet e drejtpërdrejta që do të kryhen nga Rezerva e Shtetit për trajtimin dhe shitjen e këtyre ndihmave, si dhe 5 për qind mbi këtë shumë, i mbeten Rezervës së Shtetit nga të ardhurat e shitjes. Në buxhetin e shtetit do të derdhet vlefata e fondit kundërparti, që përfaqëson diferencën ndërmjet të ardhurave nga shitja dhe pjesës që i mbetet Rezervës së Shtetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit t'i mbledhë të ardhurat nga shitja e këtyre ndihmave në llogaritë bankare të saj dhe, pasi të zbresë pjesën që i takon, diferencën ta derdhë në llogarinë përkatëse të fondeve kundërparti të Ministrisë së Financave. Brenda datës 15 të çdo muaji, t'i raportojë Ministrisë së Financave sasinë e ardhura e të shitura, vleftën e të ardhura të realizuara, pjesën e vet dhe vleftën për buxhetin e shtetit për muajin paraardhës.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, si përfaqësuese e shtetit shqiptar, të ndjekë me donatorët sistemimin, sipas dispozitave ligjore, të diferencave të mundshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi